

Sipas procesit të planifikimit kombëtar të përshtatjes

# PLANIT KOMBËTAR I PËRSHTATJES TË SHQIPËRISË PLANI I KOMUNIKIMIT DHE ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT 2026-2036



GREEN  
CLIMATE  
FUND



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT



## **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Republikës së Shqipërisë**

Tetor 2025

### **Autorët:**

Clara Ariza

Ares Filto

### **Koordinuar nga:**

Laureta Dibra, UNDP NAP Project Coordinator

### **Redaktorë dhe kontribuues të tjerë:**

Inês Ferreira (Global Factor)

María Florencia Lang (Global Factor)

Soraya Cuesta (Global Factor)

Claudia Ramos (Global Factor)

Joselyn Manosalvas (Global Factor)

### **Deklaratë për mospranim përgjegjësie**

Pikëpamjet e shprehura në këtë produkt informativ janë të autorit (autorëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo politikat e "Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara" (UNDP), agjencive donatore apo shteteve anëtare të UNDP-së. Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë produkt informativ nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë mendimi nga ana e UNDP-së në lidhje me statusin ligjor të asnjë vendi, territori, qyteti ose zone, ose të autoriteteve të tyre, apo në lidhje me përcaktimin e fronteve ose kufijve të tyre.

Sipas procesit të planifikimit kombëtar të përshtatjes

# PLANIT KOMBËTAR I PËRSHTATJES TË SHQIPËRISË PLANI I KOMUNIKIMIT DHE ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT 2026-2036



# Tabela e Përmbajtjes

---

<b>Përmbledhje ekzekutive</b>	09
<hr/>	
<b>01. Hyrje</b>	10
<b>1.1. Historiku dhe roli i PKP-së</b>	11
<b>1.2. Harmonizimi me kuadrot kombëtarë dhe ndërkombëtarë</b>	12
<b>1.3. Sfidat dhe mundësitë lidhur me komunikimin</b>	12
<hr/>	
<b>02. Metodologjia dhe procesi</b>	14
<hr/>	
<b>03. Kuadri strategjik</b>	16
<hr/>	
<b>04. Audiencat</b>	20
<b>4.1. Palët kryesore të interesit</b>	21
<b>4.2. Angazhimi i palëve të cenueshme dhe të marginalizuara</b>	22
<b>4.3. Mesazhet kryesore të advokimit</b>	22
<b>4.4. Temat kryesore dhe mesazhet e përshtatura</b>	22
<b>4.5. Mesazhet kryesore të komunikimit për PKP-në</b>	25
<b>4.6. Faktorët nxitës strategjikë për mesazhet e advokimit</b>	28

---

---

<b>05.</b> Kanalet e komunikimit dhe platformat digjitale	32
---	----

---

<b>06.</b> Angazhimi i palëve të interesit në Planin Kombëtar të Përshtatjes të Shqipërisë	34
<b>6.1.</b> Strategjitë e hartëzimit dhe angazhimit	35
<b>6.2.</b> Qasjet përfshirëse	35
<b>6.3.</b> Veçoritë ndërvepruese për angazhimin e palëve të interesit	36

---

<b>07.</b> Sistemet për marrjen e komenteve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm	38
--	----

---

<b>08.</b> Plani i zbatimit (2026–2028)	40
---	----

---

<b>09.</b> Sfidat, pengesat dhe përshtatja sipas sfidave në të ardhmen	44
--	----

---

<b>10.</b> Konkluzione dhe thirrje për veprim	46
---	----

---

# Lista of Tabelave

---

**Tabela 1.** Objektiva e komunikimit të PKP-së 23

---

**Tabela 2.** Mesazhet e komunikimit të PKP-së 26

---

**Tabela 3.** Plani i zbatimit i PKAPI-së (2026–2028) 41

---

# Lista e Shkurtesave dhe Shkurtimeve

<b>PNK</b>	Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike
<b>PKAPI</b>	Plani Kombëtar i Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit i Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë
<b>OSHC</b>	Organizatë e Shoqërisë Civile
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>FGJK</b>	Fondi i Gjellbër për Klimën
<b>PVP</b>	Plani Vendor i Përshtatjes
<b>MM</b>	Ministria e Mjedisit
<b>PKP</b>	Plani Kombëtar i Përshtatjes
<b>OJQ</b>	Organizatë joqeveritare
<b>SK</b>	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
<b>PPP</b>	Partneritet Publik Privat
<b>NJSHP</b>	Njoftimet e Shërbimit Publik
<b>OZHQ</b>	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>KKKBNK</b>	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara



# Përmbledhje Ekzekutive

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është një prioritet kombëtar për Shqipërinë që ka rëndësi thelbësore për mbrojtjen e zhvillimit socio-ekonomik, infrastrukturës dhe trashëgimisë natyrore të vendit. Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) i Shqipërisë ofron një kuadër strategjik për të integruar aspektet e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin e politikave dhe në sektorët ekonomikë. Plani i Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit mbështet PKP-në duke i përkthyer masat teknike të përshtatjes në mesazhe të aksesueshme dhe të udhëhequra nga veprimet që mobilizojnë politikëbërësit, qeverisjen vendore, sektorin privat dhe komunitetet e cenueshme.

Plani fokusohet në pesë sektorë prioritarë të zhvillimit, përkatësisht bujqësia, energjia, turizmi, zhvillimi urban dhe transporti, të cilët janë sektorë thelbësorë për ekonominë e Shqipërisë, por tejet të cenueshëm ndaj ndikimeve klimatike. Promovimi i zgjidhjeve inteligjente ndaj klimës, si p.sh. kulturat bujqësore rezistente ndaj thatësirës, diversifikimi i energjisë së rinovueshme, infrastruktura e gjelbër urbane dhe rrjetet e qëndrueshme të transportit, fuqizon qëndrueshmërinë afatgjatë. Këto masa përmirësojnë sigurinë ushqimore, stabilitetin energjetik, si dhe qëndrueshmërinë turistike e urbane, dhe janë në përputhje me strategjitë kombëtare dhe angazhimet globale si OZHQ-të dhe Marrëveshja e Parisit.

Për të angazhuar në mënyrë efikase palë të ndryshme të interesit, ky plan ofron instrumente sipas sektorëve specifikë, workshop-e për ngritjen e kapaciteteve, narrativa digjitale dhe platforma ndërvepruese, për të fuqizuar drejtuesit në nivel bashkie, OJF-të dhe bizneset. Iniciativat me bazë shkollën dhe fushatat e udhëhequra nga të rinjtë do të promovojnë më tej praktikat inteligjente ndaj klimës, duke krijuar një brez kampionësh në fushën e klimës, të angazhuar për

të vazhduar përpjekjet për përshtatjen me kalimin e kohës. Duke njohur rëndësinë e përfshirjes, plani u kushton vëmendje të veçantë palëve të cenueshme, grave dhe të rinjve, me qëllim që procesi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të jetë një proces gjithëpërfshirës dhe me fokus njeriun.

Si përfundim, PKP-ja dhe Plani i Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit i Shqipërisë përfaqësojnë një thirrje të bashkuar për veprim. Duke i shndërruar ndryshimet klimatike në prioritet kombëtar, duke nxitur përfshirjen dhe duke forcuar partneritetet, Shqipëria do të mbrojë burimet e saj natyrore, do të përmirësojë qëndrueshmërinë e komunitetit dhe do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm. Këto përpjekje kolektive do të ndërtojnë një të ardhme të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike për brezat e ardhshëm.

# 01

**Hyrja dhe  
Konteksti**

## 1.1 Historiku dhe roli i PKP-së

Ndryshimet klimatike përbëjnë një kërcënim të afërt ndaj stabilitetit socio-ekonomik, burimeve natyrore dhe sektorëve kyçë ekonomikë të Shqipërisë. Në vitet e fundit, përmbytjet shkatërruese, thatësitat e tejzgjatura dhe zjarret masive me pasoja shkatërruese kanë shkaktuar shpërngulje masive, kanë dëmtuar infrastrukturën kritike dhe kanë pasur ndikim të rëndë në jetën bujqësore. Temperaturat në rritje dhe modelet e paparashikueshme të reshjeve vazhdojnë të kërcënojnë sektorët e bujqësisë, turizmit dhe zhvillimit urban, duke e kthyer përshtatjen në një prioritet urgjent kombëtar.

Sektorët kyçë të Shqipërisë, si bujqësia, energjia, turizmi, transporti dhe zhvillimi urban kanë një rëndësi kritike për rritjen socio-ekonomike të vendit, por këta sektorë po bëhen gjithnjë e më të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Pa veprime të menjëhershme e të koordinuara, këto risqe do të intensifikohen, duke vënë në rrezik progresin ekonomik dhe mirëqenien e komunitetit. Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP), i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), me mbështetjen financiare të Fondit të Gjëlber për Klimën (FGJK), shërben si përgjigja strategjike e Shqipërisë. Duke integruar masat e përshtatjes në kuadrot kombëtarë dhe vendorë të zhvillimit, PKP-ja synon të rrisë qëndrueshmërinë, të mbrojë sektorët jetësorë dhe të sigurojë një të ardhme të qëndrueshme për të gjithë.

PKP-ja shërben si një strategji e unifikuar, e cila trajton cenueshmëritë në sektorë të ndryshëm për të mbrojtur mjetet e jetesës, infrastrukturën dhe ekosistemet. Bujqësia, një ndër sektorët kryesorë të punësimit në Shqipëri, është veçanërisht e rrezikuar nga thatësitat dhe modelet e ndryshueshme të reshjeve. Këto ndryshime kërcënojnë sigurinë ushqimore dhe të ardhurat në zonat rurale. Energjia hidrike, një burim kryesor i energjisë, po preket gjithnjë e më shumë nga mungesa e ujit, ndërsa turizmi, një ndër faktorët nxitës të ekonomisë, po përballlet me problematika si rritja e nivelit të detit dhe zjarret masive. Infrastruktura e transportit dhe ajo urbane ekspozohen në mënyrë të ngjashme ndaj përmbytjeve dhe valëve të të

nxehetit. Këto cenueshmëri kërkojnë veprime të forta ndërsektoriale për të rritur qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.

Një gur themeli i PKP-së është zhvillimi i Planeve Vendore të Përshtatjes (PVP) për tetë bashki: Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Përmet dhe Vlorë. Këto plane janë përshtatur për të trajtuar risqet klimatike specifike për rajonet dhe për të ofruar zgjidhje të synuara, si p.sh. praktika bujqësore inteligjente ndaj klimës, infrastrukturë të qëndrueshme dhe sisteme të përmirësuara të menaxhimit të burimeve ujore. PVP-të janë zhvilluar përmes konsultimeve të gjera me palët e interesit dhe u japin prioritet strategjive të përshtatjes të udhëhequra nga komuniteti që pasqyrojnë nevojat unike të secilit rajon. Ato e vënë gjithashtu theksin te ngritja e kapaciteteve, duke i pajisur institucionet e qeverisjes vendore me mjetet për zbatimin e reagimeve efikase ndaj ndryshimeve klimatike. Megjithatë, suksesi i PKP-së shkon përtej planifikimit teknik. Ai varet nga një strategji komunikimi efikase dhe nga pjesëmarrja aktive e të gjitha palëve të interesit për ta lartësuar planin në nivelin e një prioriteti kombëtar. Rritja e ndërgjegjësimit rreth PKP-së dhe objektivave të tij është thelbësore për rritjen e njohurive dhe sigurimin e mbështetjes nga agjencitë qeveritare, komunitetet lokale, sektori privat dhe shoqëria civile. Komunikimi efikas shërben për të eliminuar mangësitë, për të mobilizuar burimet dhe për të harmonizuar interesat e shumëllojshme, ndërsa angazhimi gjithëpërfshirës i palëve të interesit garanton se çdo zë do të dëgjohet, veçanërisht zëri i palëve të cenueshme dhe të marginalizuara.

Për këtë qëllim, Plani i Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit shërben si një katalizator për përkthimin e aspekteve teknike të PKP-së në informacione të aksesueshme e konkrete. Duke demonstruar arritjet konkrete të PVP-ve dhe duke theksuar nevojën urgjente për përshtatje, plani mund të marrë hov dhe të frymëzojë veprime të përbashkëta. Kjo qasje e integruar e lartëson PKP-në në nivelin e një prioriteti kombëtar dhe nxit njëkohësisht angazhimin e përbashkët për të krijuar një Shqipëri të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike.

## 1.2 Harmonizimi me kuadrot kombëtarë dhe ndërkombëtarë

Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) është mbështetur fuqimisht në prioritetet kombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, duke shërbyer si një mjet strategjik për të adresuar risqet klimatike, në përputhje me objektivat më të gjerë të zhvillimit. Në nivel kombëtar, PKP-ja mbështet objektivat e parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), e cila e vë theksin te rritja e qëndrueshme ekonomike duke mbrojtur njëkohësisht burimet natyrore dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë ndaj sfidave mjedisore. PKP-ja ofron një kuadër për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në politikat sektoriale, duke u siguruar që bujqësia, energjia, turizmi, transporti dhe zhvillimi urban të jenë të pajisur për të adresuar risqet klimatike në zhvillim.

Në nivel vendor, PVP-të vënë në zbatim PKP-në, duke adresuar cenueshmëritë specifike sipas rajonit, si përmbytjet, thatësitat dhe valët e të nxehtit. Duke promovuar zgjidhje si ripyllëzimi, infrastruktura e qëndrueshme dhe menaxhimi i përmirësuar i burimeve ujore, këto plane përafrohen me strategjitë e bashkive dhe synojnë një zbatim efikas.

Në nivel ndërkombëtar, PKP-ja nënvizon përkushtimin e Shqipërisë ndaj Marrëveshjes së Parisit dhe Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK). Plani kontribuon në përpjekjet globale për përmbushjen e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 13 (Veprim për klimën), duke demonstruar udhëheqjen e Shqipërisë në qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Partneritetet me organizata si UNDP-ja dhe FGJK-ja garantojnë përshkallëzimin, qëndrueshmërinë dhe harmonizimin e PKP-së me prioritetet globale.

Kjo koherencë me kuadrot kombëtarë, vendorë dhe ndërkombëtarë thekson rolin e PKP-së si

Shqipëria po e njej gjithnjë e më shumë urgjencën e ndryshimeve klimatike dhe nevojën kritike për të kapërcyer hendekun e komunikimit midis politikëbërësve dhe qytetarëve. Komunikimi efektiv është thelbësor për t'i bërë ndikimet klimatike të prekshme dhe për të mobilizuar veprim kolektiv.

një mekanizëm unifikues për përmirësimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe për shfrytëzimin e burimeve dhe partneriteteve, duke garantuar që përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike të bëhet dhe të mbetet një prioritet kombëtar.

## 1.3 Sfidat dhe mundësitë lidhur me komunikimin

Shqipëria po njej gjithnjë e më shumë peshën e ndryshimeve klimatike dhe nevojën për të eliminuar mangësitë në komunikim midis politikëbërësve dhe qytetarëve. Kjo thekson rëndësinë që ka komunikimi strategjik për t'i bërë sa më të qarta ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe për të nxitur veprime të përbashkëta.

Gjatë Konferencës për Planet Vendore të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri, të organizuar më 18 qershor 2024, Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, theksoi se “*Termi “ndryshime klimatike” shpeshherë është dukur si diçka abstrakte, që i përket dimensioneve virtuale ose mediatike. Ditët e sotme, ndikimet e ndryshimeve klimatike, si zjarret, përmbytjet, rrëshqitjet e tokës dhe erozioni bregdetar, janë të pamohueshme në jetën tonë të përditshme.*” Ky realitet bën thirrje për marrjen e masave të menjëhershme për angazhimin e qytetarëve, bizneseve dhe komuniteteve në

mbarë vendin për të adresuar risqet klimatike dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme.

Sipërfaqja modeste e Shqipërisë është në kontrast me diversitetin gjeografik dhe varësinë e saj ekonomike në sektorët me ndjeshmëri ndaj klimës, si bujqësia, turizmi dhe energjia. Megjithatë, komunikimi i këtyre risqeve klimatike dhe nevoja urgjente për përshtatje mbetet një sfidë. Ekziston ende një hendek midis kuadrove të politikave dhe njohurive të publikut, pasi shumë qytetarë vazhdojnë t'i perceptojnë çështjet klimatike si të aspekte të largëta ose që nuk lidhen me jetën e tyre të përditshme. Kjo mangësi në komunikim pengon miratimin më të gjerë të praktikave inteligjente ndaj klimës dhe kufizon pjesëmarrjen e publikut në përpjekjet për përshtatjen.

Kjo sfidë thellohet më tej si pasojë e shumëllojshmërisë së palëve të interesit të përfshira në procesin e PKP-së, duke filluar nga agjencitë qeveritare dhe njësitë e qeverisjes vendore, e deri te shoqëria civile, bizneset dhe komunitetet e cënueshme. Secili grup ka shqetësime, prioritete dhe kapacitete unike, të cilat kërkojnë qasje komunikimi të posaçme.

Për më tepër, terminologjia teknike dhe përmbajtjet e ngarkuara me politika mund të distancojnë audiencat joeksperte, ndërsa komunitetet rurale dhe të marginalizuara shpeshherë përballen me pengesa për të aksesuar informacione kritike. Siç u konstatua nga ministrja Kumbaro, *“Ne përballemi me një sfidë të madhe për të vendosur ura komunikimi midis politikave dhe qytetarëve në sektorët e bujqësisë, peshkimit, ndërtimit dhe turizmit. Ata po i shfrytëzojnë burimet natyrore pa pasur ndërgjegjësim të mjaftueshëm mbi pasojat globale.”*

Megjithatë, këto sfida paraqesin gjithashtu mundësi për të nxitur ndryshime domethënëse përmes komunikimit strategjik. Duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke theksuar ndikimet

konkrete të ndryshimeve klimatike, komunikimi mund të mbyllë hendekun midis politikave abstrakte dhe përvojave reale. Historitë e suksesit, si p.sh. fushata kombëtare e ripyllëzimit e drejtuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, demonstrojnë se si përpjekjet kolektive, të cilat përfshinin 50 bashki, rezultuan në mbjelljen e 300 000 fidanëve. Kjo iniciativë mobilizoi komunitetet, shkollat dhe bizneset, duke treguar fuqinë e bashkëpunimit në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe nxitjen e kujdesin për mjedisin.

Në nivel vendor, bashkia e Vlorës ka marrë masa proaktive për të luftuar erozionin bregdetar dhe për të rehabilituar Pyllin e Sodës, ndërsa përpjekjet e Gjirokastrës me synim ripyllëzimin përreth qendrave urbane zbusin riskun e zjarreve dhe parandalojnë rrëshqitjet e tokës. Ndarja e këtyre shembujve përmes narrativave të aksesueshme dhe tërheqëse mund të frymëzojë një angazhim më të gjerë të publikut dhe të nxisë ndjenjën e përgjegjësisë kolektive për të adresuar ndryshimet klimatike. Për më tepër, shfrytëzimi i platformave digjitale, zgjerimi i partneriteteve me median dhe përdorimi i metodave krijuese të informimit mund të përmirësojnë shtrirjen dhe efikasitetin e përpjekjeve të komunikimit. Angazhimi gjithëpërfshirës i palëve të interesit, i kombinuar me mesazhe të qarta dhe tërheqëse, garanton që zërat e ndryshëm të dëgjohen dhe që strategjitë e përshtatjes të mbështeten nga të gjithë sektorët e shoqërisë.

Rrjedhimisht, komunikimi strategjik është thelbësor në shndërrimin e PKP-së në prioritet kombëtar. Ai jo vetëm rrit ndërgjegjësimin ndaj risqeve klimatike, por gjithashtu mobilizon palët e interesit që të udhëheqin përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke garantuar që Shqipëria të jetë e mirëpajisur për të mbrojtur trashëgiminë e saj natyrore dhe për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme përmes përshtatjes në nivel vendor dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë.

# 02

## Metodologjia and Prosesi

**Plani i Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit për PKP-në e Shqipërisë ka zbatuar një qasje me pjesëmarrje. Plani i ka dhënë përparësi ngritjes së një kuadri efikas të komunikimit, të mbështetur nga angazhimi strategjik i palëve të interesit. Kjo qasje garanton që objektivat e PKP-së të shprehen qartë, të kuptohen gjerësisht dhe të përqafohen nga audienca të ndryshme, duke nxitur njëkohësisht marrjen e veprimeve të përbashkëta që nevojiten për ta shndërruar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në një prioritet kombëtar.**

Për të përcaktuar kontekstin gjithëpërfshirës për planin, u hartua një deklaratë e shkurtër përmes konsultimeve:

Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) është një kuadër strategjik që synon të mbrojë zhvillimin socio-ekonomik dhe trashëgiminë natyrore të Shqipërisë duke rritur qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Nëpërmjet angazhimit gjithëpërfshirës të palëve të interesit dhe komunikimit të synuar, PKP-ja kërkon të përkthejë nevojën urgjente për përshtatje në veprime të përbashkëta, duke e shndërruar qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike në një prioritet të përbashkët kombëtar.

Procesi filloi me shqyrtimin e dokumentacionit dhe me konsultimet fillestare me palët kryesore të interesit, duke përfshirë ekspertët teknikë dhe ekipin zbatues të UNDP-së. Ky hap synonte të mblidhte të dhëna mbi sfidat e Shqipërisë në drejtim të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, të rishikonte strategjitë ekzistuese dhe të identifikonte nevojat paraprake të komunikimit. Këto konsultime hodhën themelet për të kuptuar kontekstin e PKP-së dhe mbështetën hartimin e strategjisë së komunikimit duke theksuar çështjet dhe mundësitë kryesore.

Bazuar në këto gjetje, u organizua një workshop i përbashkët me përfaqësues të palëve të interesit dhe medias për të përsosur qasjen e komunikimit, për të përcaktuar prioritetet e qarta në dhënie dhe mesazheve dhe për të përmirësuar bashkëpunimin. Në këtë workshop morën pjesë politikbërës, ekspertë teknikë, të rinj dhe përfaqësues të medias, duke nxitur një dialog shumëdisiplinor për të komunikuar me efikasitet

objektivat e PKP-së në pesë sektorët kyç të prekur nga klima. Workshop-i eksploroji metoda inovatore për angazhimin e audiencës, si p.sh. platformat digjitale dhe informimi i komunitetit, duke garantuar njëkohësisht gjithëpërfshirjen përmes amplifikimit të zërave të marginalizuar dhe mbështetjes së parimeve të barazisë dhe aksesueshmërisë. Përfaqësuesit e medias u inkurajuan që të zbatonin një qasje të orientuar drejt zgjidhjeve, duke theksuar historitë e suksesit nga Planet Vendore të Përshtatjes (PVP) dhe duke demonstruar përfitimet konkrete të përpjekjeve për përshtatjen. Gjithashtu, në fokus kryesor ishte përshtatja e përmbajtjes për platforma dhe audienca të ndryshme, duke garantuar që mesazhet të përhapen gjerësisht dhe të përcjellin me efikasitet nevojën urgjente dhe rëndësinë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Përmes kësaj qasjeje bashkëpunuese, workshop-i theksoi rëndësinë e një komunikimi të unifikuar e me ndikim për të nxitur angazhimin dhe mbështetjen ndaj objektivave të PKP-së.

PKAPI-ja iu nënshtrua një procesi bashkëpunues validimi, me kontribute nga agjencitë qeveritare, autoritetet vendore, shoqëria civile, partnerët e mediave dhe ekspertët, të cilat u përfshinë në versionin përfundimtar. Ky proces i vazhdueshëm garantoj që kuadri i komunikimit të planit të ishte jo vetëm gjithëpërfshirës, por edhe i zbatueshëm, në përputhje me prioritetet kombëtare, dhe të nxishte përfshirjen e gjerë. Duke e vendosur në fokus kryesor komunikimin e qartë dhe të synuar, të mbështetur nga angazhimi i palëve të interesit, metodologjia garanton që mesazhet e PKP-së të shpërndahen dhe të kuptohen gjerësisht. Ky fokus i dyfishtë forcon ndërgjegjësimin e publikut dhe nxit një angazhim të përbashkët për të avancuar agjendën e Shqipërisë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke e bërë atë një gur themeli të zhvillimit të qëndrueshëm.

# 03

## **Kuadri Strategjik**

## Objektivi strategjik i PKAPI-së

Të caktohet përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike si një prioritet kombëtar në Shqipëri duke shfrytëzuar komunikimin strategjik si mjet për të angazhuar palët e interesit, për të nxitur veprimet e përbashkëta dhe për të zhvilluar qëndrueshmëri afatgjatë në të gjithë sektorët kyç të ekonomisë.

Plani e parashikon përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike si një prioritet kombëtar që nxit marrjen e vendimeve përkatëse, veprime të përbashkëta dhe qëndrueshmëri afatgjatë. Përmes komunikimit të synuar dhe gjithëpërfshirës, plani synon të transformojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, nga një kuadër politikash në një lëvizje që përkrahët nga palët e interesit në të gjitha nivelet e shoqërisë, pra nga politikëbërësit, shoqëria civile, sektori privat dhe komunitetet lokale. Komunikimi strategjik shërben si katalizator për të angazhuar palët e interesit, për të rritur njohuritë dhe për të frymëzuar marrjen e veprimeve për një Shqipëri të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike..

### Janë zhvilluar pesë objektiva për të arritur këtë qëllim strategjik:

**1**  
OBJEKTIVI

#### Rritja e ndërgjegjësimit për klimën **Climate Awareness**

Ky objektivi thekson rritjen e ndërgjegjësimit kombëtar për risqet klimatike dhe masat e përshtatjes përmes mesazheve të synuara, fushatave digjitale dhe shtrirjes së aktiviteteve në komunitet. Veprimtaritë do të paraqesin risqet klimatike, do të shfaqin praktikatat e suksesshme të përshtatjes dhe do të luftojnë keqinformimin, duke siguruar që publiku i gjerë të njohë rëndësinë e përshtatjes për zhvillimin me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

**2**  
OBJEKTIVI

#### Forcimi i koordinimit institucional

Ky objektivi përqendrohet në krijimin e partneriteteve dhe koordinimit midis institucioneve dhe sektorëve për të siguruar që ministritë, bashkitë dhe agjencitë teknike të kenë njohuritë dhe burimet e nevojshme për të integruar përshtatjen në vendimmarrje. Veprimtaritë do të përfshijnë workshop-e, seanca trajnimi dhe konsultime me ekspertë, duke siguruar që vendimmarrësit dhe palët e interesit të kenë qasje në njohuri të besueshme dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të efektshme për prioritetet e përshtatjes.

**3**  
OBJEKTIVI

#### Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në narrativat e politikave

Ky objektivi siguron që politikëbërësit të mbështeten me instrumente komunikimi (të tilla si përmbledhje politikash, dialogë dhe mjete të synuara për advokim), që përfshijnë përshtatjen në planet kombëtare dhe vendore të zhvillimit. Duke lidhur përshtatjen me përfitimet ekonomike dhe sociale, PKAPI-i do të nxisë angazhim më të fortë politik dhe integrimin e prioritetëve klimatike në politika dhe plane.

## 4 OBJEKTIVI

### Fuqizimi i zërave të cenueshëm

Ky objektivi promovon përfshirjen duke krijuar mundësi angazhimi në planifikimin e përshtatjes dhe vendimmarrje për palët e cenueshme. Veprimtaritë do të përfshijnë workshop-e të synuara, materiale edukative të përshtatura dhe nisma shkollore, duke u mundësuar grave, të rinjve dhe komuniteteve të marginalizuara të formësojnë agjendën e Shqipërisë për aftësitë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike..

## 5 OBJEKTIVI

### Vazhdimi i angazhimit dhe dialogut

Ky objektivi thekson rëndësinë e vazhimit të angazhimit me kalimin e kohës. Aktivitetet do të përqendrohen në paraqitjen e arritjeve lidhur me përshtatjen, krijimin e platformave ndërvepruese për ndarjen e njohurive dhe vlerësimet e vazhdueshme, si dhe promovimin e bashkëpunimit me sektorin privat për të siguruar burime dhe për të nxitur veprime të vazhdueshme.

### Parimet udhëzuese

Plani i Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit bazohet në parimet e mëposhtme udhëzuese:

---

**Mesazhet me bazë shkencore:** Marrja e masave për të garantuar që komunikimi lidhur me përshtatjen të jetë pjesë e të dhënave klimatike, vlerësimeve të rrezikut dhe studimeve sektoriale, siç parashikohet në PKP.

---

**Angazhimi shumëpalësh:** Forcimi i bashkëpunimit midis qeverisë, sektorit privat, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë për të përshpejtuar përshtatjen.

---

**Lokalizimi i strategjive:** Marrja e masave për të garantuar që Planet Vendore të Përshtatjes (PVP) të komunikohen dhe zbatohen me efikasitet në nivel bashkie.

---

**Përfshirja dhe barazia:** Prioritizimi i qasjeve me përgjegjshmëri gjinore dhe vendimmarrjes me pjesëmarrje për të forcuar zërat e grave, të rinjve dhe komuniteteve të marginalizuara.

---

**Transparenca dhe llogaridhënia:** Ngritja e mekanizmave të qartë të monitorimit për të gjurmuar progresin në PKP, angazhimin publik dhe ndikimin e komunikimit.

Komunikimi efikas dhe angazhimi i palëve të interesit janë thelbësore për të garantuar zbatimin e suksesshëm të Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë. Për të arritur këtë, do të kombinohen faktorët nxitës strategjikë për të rritur ndërgjegjësimin, për të forcuar pjesëmarrjen dhe për të ruajtur angazhimin afatgjatë në përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Do të përdoret një **qasje komunikimi në disa platforma** për të garantuar aksesueshmëri të gjerë dhe gjithëpërfshirje. Duke integruar mjetet digjitale, rrjetet sociale, mediat tradicionale dhe platformat komunitare, mesazhet për përshtatjen do të arrijnë te vendimmarrësit, bizneset, njësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetet e cënueshme në një mënyrë që përputhet me nevojat dhe interesat e tyre specifike. Këto përpjekje do të sigurojnë që përshtatja jo vetëm të konsiderohet si një prioritet kombëtar, por edhe të integrohet në politikat sektoriale dhe masat në nivel vendor.

**Bashkëpunimi me mediat tradicionale dhe digjitale** do të luajë një rol kyç në forcimin e mesazhit të PKP-së, duke rritur vizibilitetin publik dhe duke ruajtur ndërgjegjësimin në terma afatgjatë. Partneritetet me median do të ndihmojnë për të prezantuar gjerësisht historitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, duke e vënë theksin tek iniciativat e suksesshme, sfidat dhe mundësitë. Për të siguruar konsistencën në mesazhe, do të zhvillohen instrumente mediatike, njoftime për shtyp dhe seanca trajnimit për gazetarët, duke i pajisur profesionistët e medias me burimet e nevojshme për të raportuar me saktësi mbi progresin në drejtim të përshtatjes.

**Ngritja e kapaciteteve të palëve të interesit** është një tjetër faktor nxitës themelor, i cili garanton që institucionet, bizneset, organizatat e shoqërisë civile dhe liderët në komunitet të jenë të mirëpajisur për të marrë pjesë

aktivisht në përpjekjet për përshtatjen. Përmes materialeve të përshtatura të komunikimit, seancave praktike të trajnimit dhe workshop-eve ndërvepruese, palët e interesit do të fitojnë mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të promovuar dhe zbatuar me efikasitet masat e përshtatjes. Platformat e dedikuara për dialogët mbi politikat dhe për diskutimet teknike do të mbështesin më tej shkëmbimin e njohurive dhe të nxënit në nivel institucional, duke krijuar një kulturë të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në të gjitha nivelet.

#### **Prezantimi i ndikimit konkret të përpjekjeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike**

do të jetë thelbësore në ndërtimin e besimit, besueshmërisë dhe të ritmit për masat e mëtejshme. Duke demonstruar rezultate konkrete nga zbatimi i Planeve Vendore të Përshtatjes (PVP) dhe iniciativave të tjera të PKP-së, palët e interesit do të shohin shembuj konkretë të përshtatjes ndaj ndryshime klimatike. Rastet studimore, vlerësimet para dhe pas zbatimit, si dhe përmbajtjet ndërvepruese digjitale do të ilustrojnë mënyrën se si investimet në drejtim të përshtatjes përmirësojnë sigurinë ushqimore, mbrojnë infrastrukturën dhe rrisin qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.

Strategjia e komunikimit, në mënyrë që të mbetet efikase dhe e përshtatshme, duhet të jetë fleksibël dhe gjithëpërfshirëse, dhe të garantojë që qasjet e angazhimit të evoluojnë paralelisht me ndryshimin e risqeve klimatike, politikat dhe prioritetet e palëve të interesit. Mekanizmat për dhënie e komenteve në mënyrë periodike, konsultimet me pjesëmarrje dhe anketat për palët e interesit do të integrohen për të vlerësuar ndikimin e komunikimit dhe për të përsosur mesazhet. Këto kontribute do të sigurojnë që mesazhet për përshtatjen të mbeten të rëndësishme, të bazuara në prova dhe të aksesueshme nga të gjitha segmentet e shoqërisë, veçanërisht nga palët e cënueshme dhe të marginalizuara.

04

**Audiencat**

## 4.1 Palët kryesore të interesit

Angazhimi i palëve kryesore të interesit është thelbësor për zbatimin efektiv dhe suksesin afatgjatë të Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë. Këto palë interesi, duke përfshirë institucionet qeveritare, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile (OSHC), akademinë, median dhe partnerët ndërkombëtarë, luajnë një role të ndryshme por të ndërlidhura në nxitjen e përpjekjeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Një strategji komunikimi dhe angazhimi e mirëstrukturuar garanton që çdo grup të kontribuojë në mënyrë aktive në objektivat e Shqipërisë për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.

**Institucionet qeveritare** janë në qendër të zbatimit të PKP-së, si dhe janë përgjegjëse për të integruar masat e përshtatjes në politikat sektoriale dhe për të garantuar harmonizimin midis strategjive kombëtare dhe vendore. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, së bashku me ministritë përgjegjëse për sektorët e bujqësisë, energjisë, zhvillimit urban dhe transportit, udhëheqin veprimtaritë e planifikimit dhe financimit të përshtatjes. Në nivel bashkie, qeverisja vendore luan një rol kyç në zbatimin e Planeve Vendore të Përshtatjes (PVP), në angazhimin e komuniteteve dhe në përshtatjen e masave të përshtatjes sipas rrezeve rajonale. Për të mbështetur koordinimin institucional, strategjia e komunikimit përdor mjete si dokumentet informuese, raportet e progresit dhe workshop-et për ngritjen e kapaciteteve, duke garantuar që aktorët qeveritarë të kenë njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të integruar përshtatjen në vendimmarrje.

**Sektori privat** është faktor kyç nxitës në drejtim të përshtatjes, përmes sjelljes së investimeve, inovacionit dhe ekspertizës teknike në përpjekjet për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Industritë në bujqësi, turizëm, energji dhe transport duhet të zbatojnë në mënyrë proaktive teknologji inteligjente ndaj klimës dhe strategji për

zvogëlimin e riskut për të garantuar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë. Strategjitë e komunikimit për sektorin privat fokusohen në demonstrimin e përfitimeve ekonomike të investimeve në drejtim të përshtatjes dhe të praktikave më të mira, si dhe në shfrytëzimin e partneriteteve publike-private (PPP) për të rritur gamën e zgjidhjeve. Forumet sektoriale, udhërrëfyesit për investimet dhe fushatat e ndërgjegjësimit të bazuara në incentiva do të përdoren për të mobilizuar angazhimin e sektorit privat.

**Shoqëria civile dhe OJQ-të** shërbejnë si ura lidhëse midis politikëbërësve dhe komuniteteve, duke advokuar për zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe me fokus njeriun në drejtim të përshtatjes. Puna e tyre garanton që zëri i komunitetit, veçanërisht i palëve të cenueshme, të integrohet në politikat për përshtatjen. Për t'i mbështetur OShC-të në veprimtaritë e tyre të advokimit dhe informimit, strategjia e komunikimit parashikon instrumente të posaçme, platforma të angazhimit me pjesëmarrje dhe partneritete me median, të cilat amplifikojnë rolin e OShC-ve në zhvillimin e politikave për përshtatje.

**Institucionet akademike dhe kërkimore** ofrojnë ekspertizë shkencore, të dhëna klimatike dhe vlerësime të cenueshmërisë, duke siguruar që strategjitë e përshtatjes të jenë të bazuara në evidence dhe të përshtatura ndaj risqeve specifike klimatike në Shqipëri. Për t'i bërë kërkimet e tyre më të aksesueshme nga vendimmarrësit dhe publiku i gjerë, përpjekjet e komunikimit do ta vënë theksin te platformat për ndarjen e njohurive, raportet e thjeshtuara të përshtatjes, si dhe dialogët mbi politikat, të cilat i përkthejnë gjetjet shkencore në zgjidhje konkrete.

**Media** është thelbësore në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, duke ndikuar në perceptimin publik dhe duke garantuar llogaridhënie në përpjekjet për përshtatjen. Aktorët mediatikë ndihmojnë në ruajtjen e angazhimit publik dhe të ritmit politik duke shpërndarë narrativa të sakta e bindëse

rreth ndikimeve klimatike dhe zgjidhjeve në drejtim të përshtatjes. Strategjia e komunikimit i jep prioritet bashkëpunimeve me median tradicionale dhe digjitale, përmes njoftimeve për shtyp, programeve të trajnimit për gazetarët dhe fushatave të narrativave për përshtatjen, për të rritur mbulimin mbi qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.

**Organizatat dhe donatorët ndërkombëtarë,** duke përfshirë Fondin e Gjelbër për Klimën, UNDP-në dhe partnerë të tjerë dypalësh dhe shumëpalësh, ofrojnë burime financiare, asistencë teknike dhe harmonizim të politikave me kuadrot globale për klimën, si Marrëveshja e Parisit dhe Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 13 (Veprim për klimën). Raportet e progresit, historitë e suksesit, si dhe dialogët e nivelit të lartë mbi politikat do të garantojnë angazhim të vazhdueshëm të donatorëve, duke theksuar njëkohësisht progresin e Shqipërisë në rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.

## 4.2 Angazhimi i palëve të cënueshme dhe të margjinalizuara

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike duhet t'i japë prioritet palëve të cënueshme dhe të margjinalizuara, duke përfshirë gratë, popullsitë në zonat rurale dhe komunitetet me të ardhura të ulëta, të cilët ndikohen në mënyrë joproporcionale nga risqet klimatike. Përfshirja e tyre garanton që strategjitë e përshtatjes të jenë të barabarta, të qëndrueshme dhe me specifika sipas kontekstit, ndërsa njohuritë e tyre vendore përmirësojnë planifikimin dhe qëndrueshmërinë.

Komunikimi gjithëpërfshirës është thelbësor për Planin Kombëtar të Përshtatjes (PKP),

falë mesazheve të përshtatura në formate të aksesueshme, si gjuha vendase, përmbajtja vizuale dhe radio në nivel komuniteti, dhe mundëson angazhimin aktiv të palëve të ndryshme, veçanërisht të atyre në zonat rurale. Qasjet me pjesëmarrje, si p.sh. workshop-et në komunitet dhe palët e fokusit, u ofrojnë këtyre popullsive një platformë për të shprehur shqetësimet dhe për të gjetur bashkërisht zgjidhje që pasqyrojnë realitetet vendore.

Përpjekjet për të adresuar pengesat ndaj pjesëmarrjes, si sigurimi i transportit dhe ambienteve të aksesueshme, mundësojnë përfshirjen aktive, veçanërisht të grave dhe grupeve të margjinalizuara. Fuqizimi i këtyre komuniteteve përmes komunikimit me ndjeshmëri gjinore dhe qasjeve kulturore të përshtatshme siguron që ato të luajnë një rol aktiv në të gjitha fazat e planifikimit dhe zbatimit të përshtatjes.

## 4.3 Mesazhet kryesore të advokimit

Plani i Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit është hartuar për të përkthyer me efikasitet objektivat strategjike të Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë në mesazhe të zbatueshme, duke siguruar ndërgjegjësim, pjesëmarrje dhe bashkëpunim të gjerë në të gjithë sektorët. Përmes strategjive të synuara të komunikimit, ky plan nxit përgjegjësinë e përbashkët në drejtim të përshtatjes, duke mobilizuar aktorët kryesorë në nivel kombëtar, vendor dhe komuniteti.

## 4.4 Temat kryesore dhe mesazhet e përshtatura

Ky plan përdor tema komunikimi për të organizuar

dhe orientuar mënyrën se si u dërgohen mesazhe audiencave të ndryshme. Temat e komunikimit janë kategori të gjera mesazhesh që grupojnë ide kyçe, duke garantuar kështu konsistencë dhe qartësi. Për lehtësi referimi, ato mund të përshkruhen gjithashtu si *fusha të fokusit të komunikimit*.

Ato identifikohen nga pesë **objektivat e komunikimit të Planit të Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit (PKAPI) të PKP-së**, si dhe zbatohen në të pestë sektorët prioritarë të zhvillimit të Shqipërisë: **bujqësia dhe pylltaria, energjia, turizmi, transporti dhe zhvillimi urban**. Duke punuar me këto fusha të fokusit, plani garanton që mesazhet të jenë koherente, të bazuara në evidenca dhe me rëndësi për angazhimin e palëve të interesit në të gjitha nivelet.

Çdo temë komunikimi përkon me një nga **pesë objektivat strategjikë të PKAPI-së**, duke garantuar përafrim mes mesazheve, angazhimit të palëve të interesit dhe prioritetëve të politikave të Shqipërisë. Këta objektiva shpjegojnë rolin e masave sektoriale të PKP-së dhe angazhimet e veta më të gjera në kuadër të Marrëveshjes së Parisit dhe OZHQ-ve.

Në vetvete, objektivat e mëposhtëm, fushat e fokusit dhe mesazhet kyç nuk janë masa të politikave, por **mjete komunikimi** të krijuara për të mbështetur advokimin, për të rritur përgjegjësinë dhe për të promovuar integrimin e politikave. Ato orientojnë pozicionimin e përshtatjes në audiencat dhe sektorët të ndryshëm. Tabela më poshtë përshkruan çdo objektiv komunikimi të PKAPI-së, fushën e lidhur, mesazhet përkatese kyç dhe audiencat e synuara për mbulimin.

**Tabela 1. Objektivat e komunikimit të PKP-së**

Objektivi i komunikimit	Fusha e fokusit të komunikimit	Mesazhet kryesore	Audiencat e synuara
<b>Objektivi 1: Rritja e ndërgjegjësimit për klimën</b>	Përshtatja klimatike si një faktor nxitës i rritjes së qëndrueshme ekonomike	<p><i>-Përshtatja klimatike është çelësi për mbrojtjen e mjeteve të jetesës, stabilitetit ekonomik dhe trashëgimisë natyrore të Shqipërisë.</i></p> <p><i>-Investimi sot në drejtim të përshtatjes siguron një të ardhme të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.</i></p> <p><i>-Çdo sektor dhe komunitet luan rol. Veprimet e vogla sjellin qëndrueshmëri në nivel kombëtar.</i></p> <p><i>-Politikat më të forta për përshtatjen përmirësojnë konkurrencën, tërheqin financimet për klimën dhe krijojnë vende pune ekologjike.</i></p>	Publiku i gjerë, komunitetet vendase, rinia, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile.

Objektivi i komunikimit	Fusha e fokusit të komunikimit	Mesazhet kryesore	Audienat e synuara
<b>Objektivi 2: Forcimi i koordinimit institucional</b>	Veprime bashkëpunuese për një të ardhme të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike	<p>- <i>Përshtatja ka sukses kur të gjitha institucionet, sektori privat, academia dhe komunitetet punojnë së bashku.</i></p> <p>- <i>Partneritetet në bujqësi, energji, turizëm, transport dhe në planifikimin urban sigurojnë që përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike të jenë të qëndrueshme dhe efikase.</i></p> <p>- <i>Partneritetet publike-private (PPP) shfrytëzojnë inovacionin dhe financimet për zgjidhjet në drejtim të përshtatjes.</i></p> <p>- <i>Bujqësia inteligjente ndaj klimës rrit sigurinë ushqimore dhe krijon stabilitet në punësim, veçanërisht për gratë në zonat rurale.</i></p> <p>- <i>Infrastruktura e qëndrueshme në sektorin e energjisë, transportit dhe turizmit garanton rritje dhe stabilitet afatgjatë.</i></p> <p>- <i>Diversifikimi i energjisë diellore dhe të erës garanton siguri energjetike afatgjatë, duke reduktuar njëkohësisht gjurmën e karbonit të Shqipërisë.</i></p> <p>- <i>Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i njohurive harmonizojnë burimet dhe novacionin për një Shqipëri inteligjente ndaj klimës.</i></p> <p>- <i>Sektori privat luan një rol thelbësor në financimin e zgjidhjeve në drejtim të përshtatjes.</i></p>	Politikëbërësit në nivel kombëtar dhe vendor, autoritetet bashkiake, liderët në sektorin privat, academia.
<b>Objektivi 3: Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në narrativat e politikave</b>	Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në qeverisje dhe në kuadrot e politikave	<p>-- <i>Integrimi i përshtatjes në politikat kombëtare dhe bashkiake siguron zhvillim të qëndrueshëm.</i></p> <p>- <i>Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është një investim, jo një kosto, dhe garanton sigurinë ekonomike të Shqipërisë.</i></p> <p>- <i>Risqet klimatike duhet të merren parasysh në të gjitha vendimet e planifikimit në nivel kombëtar dhe vendor.</i></p> <p>- <i>Vendimet politike të marra sot formojnë qëndrueshmërinë e Shqipërisë në të ardhmen.</i></p> <p>- <i>Politikëbërësit luajnë një rol thelbësor në sigurimin e financimeve për klimën dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar.</i></p> <p>- <i>Nevojitet një udhëheqje e fortë për të integruar përshtatjen në të gjitha nivelet e qeverisjes.</i></p> <p>- <i>Përshtatja është një investim në sigurinë ekonomike. Jepini prioritet në vendimet tuaja.</i></p> <p>- <i>Udhëheqja e fortë nxit politikat e qëndrueshme. Bëhuni zëri që përkrah</i></p>	National and local policymakers, influential community leaders, and donors. Journalists and media outlets.

Objektivi i komunikimit	Fusha e fokusit të komunikimit	Mesazhet kryesore	Audienca të synuara
<b>Objektivi 4:</b> <b>Fuqizimi i zërave të cenueshëm</b>	Veprim gjithëpërfshirës për klimën: Askush të mos mbetet pas	<p><i>-Ndryshimet klimatike ndikojnë tek të gjithë ne, por palët e cenueshme mbajnë peshën më të rëndë. Le të sigurohemi që askush të mos mbetet pas.</i></p> <p><i>- Zgjidhjet e bazuara në komunitet, të drejtuara në nivel vendor, e bëjnë përshtatjen të efektshme dhe të qëndrueshme.</i></p> <p><i>- Investimi në drejtim të përshtatjes ndaj klimatike përmirëson mjetet e jetesës, mbron popullsitë e cenueshme dhe ndërton qëndrueshmërinë sociale.</i></p> <p><i>- Investimi në përshtatje përmirëson jetesën, mbron popullatat e cenueshme dhe përmirëson aftësitë ripërtëritëse sociale.</i></p> <p><i>-Gratë dhe komunitetet e marginalizuara duhet të jenë pjesë e vendimmarrjeve për klimën.</i></p> <p><i>-Përshtatja gjithëpërfshirëse siguron barazi, pjesëmarrje dhe përfitime të ndërsjella për të gjithë.</i></p>	Gratë, të rinjtë, popullatat në zonat rurale dhe komunitetet e marginalizuara. Organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e përfshirjes sociale.
<b>Objektivi 5:</b> <b>Vazhdimi i angazhimit dhe dialogut</b>	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike: Një përpjekje kolektive dhe e vazhdueshme	<p><i>- Përshtatja është një proces i vazhdueshëm që kërkon udhëheqje dhe bashkëpunim të qëndrueshëm.</i></p> <p><i>- Historitë e suksesit nga Planet Vendore të Përshtatjes (PVP) demonstrojnë ndikimin e përpjekjeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.</i></p> <p><i>-Shqipëria po ndërton një të ardhme të qëndrueshme. Historitë tona të suksesit na prijnë përpara.</i></p> <p><i>-Bashkëpunimi dhe ndarja e njohurive nxisin përshtatjen e qëndrueshme.</i></p> <p><i>-Demonstrimi i progresit frymëzon të tjerët.</i></p> <p><i>Së bashku, ne mund t'i përshkallëzojmë këto suksese për një ndikim më të madh.</i></p> <p><i>-Përfshirja e sektorit privat është thelbësore për të zgjeruar dhe financuar zgjidhje me aftësi ripërtëritëse.</i></p>	Qeverisja në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe aktorët e sektorit privat. Mediat dhe institucionet arsimore me qëllim ndërgjegjësimin e publikut.

## 4.5 Mesazhet kryesore të komunikimit për pkp-në

Pesë sektorët prioritarë të zhvillimit në Shqipëri: bujqësia dhe pylltaria, energjia, turizmi, transporti dhe zhvillimi urban, janë shtylla e rritjes socio-ekonomike të vendit. Megjithatë, këta sektorë përballen me risqe në rritje si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Në PKP, secili sektor mbështetet nga një sërë prioritetesh të përshtatjes, të identifikuara dhe të kostuara përmes Planit të Zbatimit. Mesazhet e mëposhtme të komunikimit të përshtatura synojnë ti përkthejnë këto prioritete sektoriale në mjete advokimi duke detajuar përfitimet e veprimit, harmonizimin e tyre me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare të Shqipërisë dhe audienca të përgjegjëse për nxitjen e ndryshimeve.

**Tablela 2. Mesazhet e komunikimit të PKP-së**

Sektori	Prioritetet e përshtatjes të PKP-së	Mesazhet kryesore	Përfitimet	Harmonizimi me angazhimet	Audienca e synuara
Bujqësia dhe pylltaria	Bujqësi inteligjente ndaj klimës dhe ujitje efikase	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bujqësia inteligjente ndaj klimës mbron kulturat bujqësore, si dhe siguron të ardhura të qëndrueshme dhe qëndrueshmëri ndaj ndryshimeve klimatike.</li> <li>Përshtatja ul risqet e thatësirave dhe përmbytjeve, duke siguruar kultura të qëndrueshme për familjet shqiptare..</li> <li>Teknikat për ujitjen e qëndrueshme dhe për ruajtjen e tokës mbrojnë ekonominë bujqësore të Shqipërisë.</li> <li>Ujitja efikase rrit qëndrueshmërinë për fermerët.</li> <li>Investimi në kultura me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës forcon jetesën rurale dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.</li> <li>Fuqizimi i grave dhe fermerëve të vegjël për përshtatjen siguron mirëqenien e komunitetit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbron sigurinë ushqimore dhe ekonominë rurale.</li> <li>Zvogëlon risqet që lidhen me thatësitat dhe me motin e paparashikueshëm.</li> <li>Mbështet fermerët e vegjël, në veçanti gratë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>OZHQ 2 (Zero Uri).</li> <li>Angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Parisit.</li> <li>Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor.</li> </ul>	Fermerët, kooperativat në zonat rurale, agrobizneset, politikëbërësit në sektorin e bujqësisë, institucionet kërkimore.
Energjia	Diversifikimi i burimeve të energjisë dhe rritja e eficiencës	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Nuk mjafton vetëm energjia hidroelektrike për të përballuar nevojat e ardhshme energjetike të Shqipërisë; diversifikimi është thelbësor.</i></li> <li><i>Energjia e rinovueshme nxit rritje të qëndrueshme dhe vende pune të gjelbra.</i></li> <li><i>Investimet në energjinë diellore dhe të erës pakësojnë shkarkimet dhe rrisin sigurinë energjetike.</i></li> <li><i>Eficienca e energjisë forcon aftësitë ripërtëritëse: veprimet e vogla sot sigurojnë stabilitet nesër.</i></li> <li><i>Diversifikimi ul cenueshmërinë nga thatësira dhe goditjet klimatike.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Garanton siguri energjetike afatgjatë.</li> <li>Redukton varësinë nga energjia hidrike dhe cenueshmërinë ndaj thatësirave.</li> <li>Krijon vende pune ekologjike dhe mbështet rritjen me nivel të ulët karboni.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>OZHQ 7 (Energji e Përballueshme dhe e Pastër).</li> <li>Strategjia Kombëtare për Energjinë e Rinovueshme.</li> <li>KKKBNK dhe objektivat klimatikë për anëtarësimin në BE.</li> </ul>	Politikëbërësit në sektorin e energjisë, kompanitë e shërbimeve utilitare, investitorët në fushën e energjisë së rinovueshme, bizneset, institucionet financiare

Sektori	Prioritetet e përshtatjes të PKP-së	Mesazhet kryesore	Përfitimet	Harmonizimi me angazhimet	Audienca të synuara
Turizmi	Infrastrukturë me aftësi ripërtëritëse ndaj klimës dhe nisma të qëndrueshme të ekoturizmit	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Përshtatja klimatike mbron ekosistemet natyrore dhe asetet turistike të Shqipërisë.</i></li> <li><i>Restaurimi dhe ripyllëzimi i bregdetit mbrojnë destinacionet kryesore të Shqipërisë.</i></li> <li><i>Ekoturizmi krijon vende pune dhe ruan trashëgiminë natyrore të vendit.</i></li> <li><i>Turizmi inteligjent ndaj klimës rrit reputacionin botëror të Shqipërisë si destinacion i qëndrueshëm.</i></li> <li><i>Turizmi i qëndrueshëm siguron konkurrueshmëri dhe rritje afatgjatë të komunitetit.</i></li> <li><i>Turizmi inteligjent ndaj klimës përmirëson reputacionin global të Shqipërisë si një destinacion kryesor i ekoturizmit.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbron zonat bregdetare dhe malore</li> <li>- Forcon ekonominë vendore dhe vendet e punës..</li> <li>- Përmirëson profilin e turizmit të qëndrueshëm të Shqipërisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>OZHQ 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike).</li> <li>- Strategjia Kombëtare e Turizmit në Shqipëri.</li> <li>- Angazhime rajonale për turizëm miqësor me klimën.</li> </ul>	Operatorët turistikë, pronarët e hoteleve, qeverisja vendore, agjencitë ndërkombëtare të turizmit
Transporti	Mbrojtja e infrastrukturës kritike të transportit nga ndryshimet klimatike dhe promovimi i lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Transporti me aftësi ripërtëritëse e mban Shqipërinë të lidhur dhe pakëson ndërprerjet.</i></li> <li><i>Rrugët dhe urat rezistente ndaj përmbytjeve dhe të nxehtit mbrojnë jetesën dhe tregtinë.</i></li> <li><i>Infrastruktura e qëndrueshme ul kostot afatgjata të riparimit.</i></li> <li><i>Transporti i qëndrueshëm urban pakëson shkarkimet dhe përmirëson lëvizshmërinë për të gjithë qytetarët.</i></li> <li><i>Investimet inteligjente ndaj klimës në sistemet e transportit mbështesin rritjen ekonomike dhe integrimin në BE.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Siguron qasje të besueshme në mallra, shërbime dhe tregje.</li> <li>- Redukton kostot e riparimit me kalimin e kohës.</li> <li>- Rrit lidhjen dhe sigurinë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- OZHQ 9 (Industri, novacion dhe infrastrukturë).</li> <li>- Mbështet objektivat afatgjata të përshtatjes të Shqipërisë.</li> </ul>	TPlanifikuesit në sektorin e transportit, inxhinierët urbanë, zhvilluesit e infrastrukturës, politikëbërësit
Zhvillimi urban	Infrastruktura e gjelbër, menaxhimi i riskut nga përmbytjet dhe planifikimi urban inteligjent ndaj klimës.	<ul style="list-style-type: none"> <li><i>Qytetet e gjelbra përmirësojnë cilësinë e ajrit, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e jetës.</i></li> <li><i>Planifikimi inteligjent ndaj klimës ul risqet nga përmbytjet dhe i nxehti.</i></li> <li><i>Përshtatja urbane e drejtuar nga komuniteti nxit rritjen dhe përgatitjen gjithëpërfshirëse.</i></li> <li><i>Menaxhimi i përmbytjeve në zonat urbane mbron banesat, bizneset dhe infrastrukturën kritike.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Redukton zonat e të nxehtit urban dhe risqet klimatike.</li> <li>- Mbron infrastrukturën dhe banesat.</li> <li>- Përmirëson qëndrueshmërinë e komunitetit dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- OZHQ 11 (Qytete dhe komunitete të qëndrueshme).</li> <li>- Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike në Shqipëri.</li> <li>- Udhëzimet e BE-së mbi qëndrueshmërinë urbane.</li> </ul>	Planifikuesit urbanë, arkitektët, drejtuesit në nivel bashkie, politikëbërësit e sektorit të banesave, zhvilluesit privatë.

## 4.6 Faktorët nxitës strategjikë për mesazhet e advokimit

Për të arritur objektivat e Planit të Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit të PKP-së, do të zbatohen pesë faktorët nxitës në vijim me aktivitete specifike, rezultate të matshme dhe shtrirje të synuar. Këto iniciativa janë krijuar për të garantuar gjithëpërfshirje, efikasitet dhe ndikim të qëndrueshëm.

PKAPI-ja është hartuar për: (i) të rritur ndërgjegjësimin mbi risqet klimatike dhe nevojat për përshtatje, (ii) të forcuar angazhimin shumësektorial në pesë sektorët prioritarë të zhvillimit, (iii) të përmirësuar integrimin e politikave dhe vendimmarrjen e bazuar në evidenca, (iv) të fuqizuar palët e cënueshme dhe për të nxitur përshtatjen me gjithëpërfshirje sociale, dhe (v) të ruajtur angazhimin afatgjatë institucional dhe të publikut në qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike.

Faktorët nxitës strategjikë të përshkruar më poshtë sigurojnë mjetet përmes të cilave do të arrihen këta objektiva, duke garantuar harmonizim dhe koherencë me PKP-në.

### Shfrytëzimi i mjeteve digjitale dhe mediave sociale

Në kuadër të PKP-së, do të mirëmbahet një faqe interneti e centralizuar për PKP-në, e cila do të shërbejë si një qendër për të gjitha përmbajtjet që lidhen me përshtatjen, duke përfshirë një hartë ndërvepruese që tregon 8 bashkitë me PVP dhe projektet e tyre për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Për më tepër, do të përfshihen raste studimore mbi iniciativat e suksesshme, si fushatat kombëtare të ripyllëzimit dhe rehabilitimi i bregdetit në Vlorë, si dhe do të raportohen përditësimet mujore mbi progresin, lajmet dhe ngjarjet e ardhshme.

Zhvillimi i tre fushatave në vit në rrjete sociale (Facebook, Instagram, LinkedIn), me tema të synuara:

- **Fushata 1:** #AdaptAlbania – Paraqitja e historive të suksesit në drejtim të përshtatjes përmes grafikëve informues, dëshmime personale dhe videove të shkurtra.
- **Fushata 2:** Vëmendja te sektorët (bujqësia, energjia, turizmi, transporti, zhvillimi urban) me përmbajtje sipas sektorit.
- **Fushata 3:** Angazhimi i komunitetit, duke përfshirë iniciativat e drejtuara nga rinia dhe komuniteti.

Në kuadër të Planit do të krijohen 10 video të shkurtra dhe grafikë informues ku theksohen rezultatet konkrete dhe objektivat e ardhshëm të përshtatjes, të përshtatura për audiencat e rrjeteve sociale. Për më tepër, Plani parashikon investime në mjete analitike për të monitoruar angazhimin e audiencës dhe për të optimizuar përmbajtjen bazuar në sjelljen e përdoruesve, si dhe raporte gjashtëmujore mbi treguesit e performancës.

### Forcimi i bashkëpunimeve me portalet mediatike

Do të krijohet një partneritet i ngushtë me tre kanale kombëtare televizive (si p.sh. RTSH, Top Channel, News24) për të transmetuar:

- Dy minidokumentarë çdo vit mbi ndikimet e ndryshime klimatike dhe masave të përshtatjes në Shqipëri.
- Katër njoftime për publikun që theksojnë nevojat urgjente për përshtatje dhe arritjet e PVP-ve.

Do të krijohen bashkëpunime me pesë gazeta kombëtare dhe portale lajmesh online për të publikuar:

- Artikuj specifikë tremujorë mbi progresin e PKP-së dhe përfitimet e tij për komunitetet

dhe sektorët.

- Profilet e kampionëve në fushën e klimës, duke përfshirë fermerët, drejtuesit në nivel bashkie dhe inovatorët e rinj.

Do të angazhohen dhjetë influencers në media dhe blogerë mjedisorë për të përforcuar mesazhet rreth përpjekjeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në platformat digjitale, me fokus audiencat rinore. Për më tepër, çdo vit do të organizohen dy workshop-e trajnimi mbi median për gazetarët, për të përmirësuar raportimin mbi ndryshimet klimatike, duke përdorur të dhënat dhe burimet e PKP-së.

### **Forcimi i gazetarisë mbi çështjet e klimës dhe adresimi i keqinformimit në fushën e klimës**

Duke pasur parasysh se ka një nivel të ulët raportimi në mediat shqiptare mbi çështjet e ndryshimet klimatike, Plani i Komunikimit i PKP-së do të integrojë ndërhyrje të synuara për të forcuar angazhimin e medias dhe për të luftuar keqinformimin.

Ky faktor nxitës strategjik është zhvilluar si rezultat i drejtpërdrejtë i Workshop-it për Angazhimin dhe Informimin e Palëve të Interesit për Planin Kombëtar të Përshtatjes të Shqipërisë (PKP), të mbajtur më 24 shkurt 2025 në Tiranë, ku pjesëmarrësit theksuan nevojën urgjente për të forcuar gazetarinë mbi çështjet e klimës, për të përmirësuar aksesin e mediave në ekspertiza të besueshme dhe për të luftuar keqinformimin në fushën e klimës.

#### **Masat kryesore përfshijnë:**

##### **Përmirësimin e kapaciteteve të medias në drejtim të gazetarisë mbi çështjet e klimës**

- Organizimi i programeve të trajnimit për gazetarët me ekspertë të klimës, duke ofruar

njohuri të specializuara mbi strategjitë e përshtatjes, kuadrot e politikave dhe interpretimin e të dhënave.

- Krijimi i një grupi të dedikuar ekspertësh për klimën, duke garantuar që gazetarët dhe politikëbërësit të kenë akses të drejtpërdrejtë në informacione të besueshme për raportimet e bazuara në evidenca.
- Lehtësimi i vizitave në terren në rajonet e prekura nga klima, duke u krijuar gazetarëve mundësinë që të shohin nga afër masat e përshtatjes dhe të përgatisin artikuj me ndikim të madh.
- Inkurajimi i gazetarisë investigative mbi çështjet e klimës, duke u dhënë gazetarëve mundësinë për të formuluar pyetje kritike dhe për t'i vënë politikëbërësit para përgjegjësisë lidhur me angazhimet për përshtatjen.
- Prodhimi i përmbajtjeve angazhuese me video dhe i historive të shkurtra në mediat sociale për t'i bërë çështjet klimatike më të aksesueshme dhe më të njohura për audiencën e gjerë.

##### **Luftën ndaj keqinformimit në fushën e klimës**

Për të adresuar problematikën e përhapur të keqinformimit në fushën e klimës, do të zbatohen nisma të synuara komunikimi:

- Zhvillimi i përmbajtjeve mediatike të bazuara në fakte që kundërshtojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes provave shkencore, keqinformimet në fushën e klimës.
- Rritja e bashkëpunimit midis gazetarëve dhe shkencëtarëve në fushën e klimës, duke i bërë të dhënat e ndërlikuara klimatike më të aksesueshme për publikun.
- Integrimi i nismave për verifikimin e fakteve në fushatat mediatike, duke u siguruar që publiku të dallojë raportimet e sakta në fushën e klimës nga keqinformimi.
- Shtrirja e programeve për njohuritë mediatike në shkolla, për t'i pajisur brezat e rinj me aftësitë për të vlerësuar në mënyrë kritike lajmet që lidhen me klimën.

### **Ofrimi i materialeve dhe trajnimeve mbi komunikimin për palët e interesit**

Për të rritur njohuritë, përpjekjet për advokim dhe përgjegjësinë vendore të Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë, do të krijohen materiale dhe programe të posaçme trajnimi për të mbështetur palët kryesore të interesit:

Instrumentet dhe materialet e posaçme edukative

- Pesë instrumente sipas sektorëve (bujqësi, energji, turizëm, transport, zhvillim urban) që ofrojnë hapa të zbatueshëm dhe të dhëna mbi nevojat dhe mundësitë e përshtatjes.
- Një udhëzues mbi angazhimin e komunitetit për drejtuesit në nivel bashkie për të lehtësuar diskutimet me popullsitë lokale duke garantuar një komunikim gjithëpërfshirës në nivel komuniteti.
- Materiale edukative për shkollat, duke përfshirë një modul për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe një libër të aktiviteteve.

### **Workshop-e trajnimi për palët e interesit**

Do të organizohen çdo vit tre workshop-e rajonale trajnimi për drejtuesit në nivel bashkie, organizatat komunitare dhe përfaqësuesit e sektorit privat mbi:

- Teknikat e advokimit për përshtatjen ndaj klimatike.
- Strategjitë efikase të komunikimit për të angazhuar audiencat e tyre përkatëse.

Për të garantuar përpjekjet e qëndrueshme të komunikimit pas zbatimit të PKP-së, rekomandohet që këto workshop-e të përfshijnë seanca të dedikuara për zyrtarët e qeverisjes vendore dhe OJF-të.

Këto seanca do t'i pajisin ata me aftësitë praktike për të zhvilluar, menaxhuar dhe ofruar në mënyrë të pavarur nisma komunikimi të përshtatura sipas nevojave të komuniteteve të tyre, duke nxitur përgjegjësinë dhe vazhdimësinë në nivel vendor.

### **Angazhimi i nxënësve si pjesëmarrës aktivë**

Me qëllim rritjen e angazhimit të nxënësve në veprimet për klimën, rekomandohet që në strategjinë për arsimin të integrohen nisma dhe aktivitete ndërvepruese të drejtuara nga studentët. Kjo qasje do të fuqizojë të rinjtë që të bëhen ambasadorë të klimës dhe kontribuues aktivë në përpjekjet e Shqipërisë në drejtim të qëndrueshmërisë. Iniciativat e propozuara përfshijnë:

- Fushata shkollore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, ku studentët promovojnë zgjidhje vendore si kursimi i ujit ose oborret e gjelbra shkollore.
- Workshop-e dhe seanca me narrativa të përshtatura për grupmoshat e ndryshme për t'i ndihmuar studentët që të kuptojnë risqet klimatike dhe rëndësinë e përshtatjes.
- Lojëra edukative dhe të nxënësve me bazë projektet, duke i inkurajuar studentët që të eksplorojnë praktika inteligjente ndaj klimës, si p.sh. riciklimi, mbjellja e pemëve, ose veprimet për kursimin e energjisë në shkollat dhe komunitetet e tyre.

### **Trajnim online në komunikimin për çështjet e klimës**

Do të organizohet një kurs trajnimi online mbi komunikimin për çështjet e klimës, i cili do të jetë i aksesueshëm nëpërmjet faqes së PKP-së. Ky kurs, me fokus tek OJF-të, arsimtarët dhe liderët në komunitet, do të ofrojë mjete praktike për krijimin e narrativave me ndikim, shfrytëzimin e platformave digjitale dhe ruajtjen e angazhimit afatgjatë të palëve të interesit.

### **Prezantimi i rezultateve të prekshme nga nismat e PKP-së.**

PKP-ja do të prezantojë 10 raste studimore mbi masat e suksesshme të përshtatjes, me fokus:

- Përpjekjet e mundshme të ripyllëzimit në Fier dhe Durrës.
- Projektet e mundshme të rehabilitimit të bregdetit në Vlorë.

- Sistemet e mundshme novatore për menaxhimin e burimeve ujore në Kukës.
- Pesë ese/konkurse me foto dhe tre seri videosh që theksojnë:
- Historitë e përfituesve (p.sh. fermerët që adoptojnë praktika inteligjente ndaj klimës).
- Situatën para dhe pas zbatimit të projekteve infrastrukturore që adresojnë përmytjet dhe thatësitrat.

Do të organizohen dy ekspozita publike vjetore në bashkitë kryesore për të prezantuar rezultatet e PVP-ve përmes prezantimeve ndërvepruese, dëshmime personale dhe përmbajtjeve multimedia. Gjithashtu, do të shpërndahet një raport progresi gjashtëmujor lidhur me përshtatjen që përmbledh arritjet e projektit dhe ndikimet e tyre konkrete.

#### **Ngritja e sistemeve për marrjen e kontributit të vazhdueshëm nga palët e interesit**

Për t'u angazhuar drejtpërdrejt me palët e interesit, në faqen e internetit të PKP-së do të lançohet një portal online për dhënien e komenteve, i cili do t'u mundësojë palëve të interesit që të:

- Dërgojnë sugjerime për projektet e vazhdueshme.
- Ndajnë të dhëna mbi nevojat dhe sfidat vendore.

Çdo vit do të organizohen tetë takime në bashki (nga një takim për secilën bashki me PVP) për të:

- Ofruar përditësime mbi projektet për përshtatjen.
- Mbledhur komentet e komunitetit dhe për t'i përfshirë ato në planifikimet e ardhshme.

Do të krijohet një grup këshillimor me palët e interesit, me përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile, akademisë dhe komuniteteve të cënueshme, për të shqyrtuar dhe për të dhënë kontribut, çdo gjashtë muaj, në strategjitë e komunikimit.

Do të shpërndahen anketa gjashtëmujore përmes emaileve dhe SMS-ve për të vlerësuar perceptimin publik mbi përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim në drejtim të dhënies së mesazheve dhe informimit.

# 05

## **Kanalet e Komunikimit dhe Platformat Digjitale**

**Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) do të shfrytëzojë një gamë të ndryshme të kanaleve të komunikimit për të garantuar angazhimin efektiv me të gjitha audiencat në Shqipëri. Do të përdoret një kombinim strategjik i platformave digjitale, mediave tradicionale dhe komunikimit në komunitete për të informuar në mënyrë efikase popullsitë urbane dhe rurale.**

**Platformat e rrjeteve sociale**, si Facebook, Instagram, LinkedIn dhe Twitter, do të jenë thelbësore për strategjinë digjitale. Këto kanale do të përdoren për të ndarë përmbajtje angazhuese, duke përfshirë grafikë informues, video të shkurtra dhe dëshmi personale, për të demonstruar histori suksesi nga Planet Vendore të Përshtatjes (PVP). Fushatat, duke përfshirë ato me hashtagun #AdaptAlbania, do ta vënë theksin te nisma si rehabilitimi i bregdetit të Vlorës dhe projektet e ripyllëzimit në Gjirokastër, duke inkurajuar pjesëmarrjen dhe diskutimin në shkallë të gjerë.

**Faqja e internetit e dedikuar e PKP-së** do të shërbejë gjithashtu si arkivi qendror për të gjitha materialet e komunikimit. Faqja do të përmbajë harta ndërvepruese, instrumente të shkarkueshme, raste studimore dhe përditësime të progresit. Ajo do të optimizohet për t'u përdorur në celular, duke garantuar aksesueshmëri për popullsitë rurale, të cilat varen kryesisht nga interneti celular. Për më tepër, faqja e internetit e PKP-së mund të përmbajë workshop-e virtuale dhe narrativa digjitale, duke u lejuar palëve të interesit që të eksplorojnë vizualisht projektet për përshtatjen.

**Kanalet tradicionale mediatike** do të luajnë një rol kyç në përforcimin e mesazheve të PKP-së. Televizionet kombëtarë, duke përfshirë RTSH-në (Radio Televizioni Shqiptar), Top Channel, News24, dhe televizionet vendore, sidomos ato të lidhur me bashkitë me PVP, do të transmetojnë dokumentarë të shkurtër, intervista me ekspertë,

si dhe njoftime për publikun që lidhin përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike me përfitimet konkrete të komuniteteve. Media e shkruar, duke përfshirë gazetat “Panorama” dhe “Shqiptarja”, do të publikojnë analiza të ekspertëve, histori specifike dhe opinione për të angazhuar politikëbërësit dhe publikun.

**Komunikimi i bazuar në komunitet** do të garantojë përfshirjen e grupeve të marginalizuara dhe të atyre në zonat rurale. Stacionet e njohura rajonale të radiove, si p.sh. Radio Tirana, Radio Gjirokastra dhe Radio Kukësi, do të transmetojnë mesazhe me rëndësi në nivel vendor, në gjuhët përkatëse, për të pasur jehonë mes audiencave të ndryshme. Do të organizohen **takime në bashki dhe workshop-e në komunitet** për të lehtësuar dialogun e drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrjen aktive në formulimin e zgjidhjeve në drejtim të përshtatjes.

Do të zbatohen mjete novatore, duke përfshirë **softuerët analitikë**, për të monitoruar efikasitetin e këtyre kanaleve. Do të gjurmohen tregues të tillë si numri i vizitorëve në faqen e internetit, angazhimi në rrjetet sociale dhe audiencat e mbuluar në televizione dhe radio për të përsosur dhe përmirësuar strategjitë e komunikimit me kalimin e kohës.

Këto kanale dhe platforma të synuara kanë për qëllim të krijojnë besim, të frymëzojnë marrjen e veprimeve dhe të nxisin një angazhim kolektiv në drejtim të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

# 06

**Angazhimi i Palëve  
të Interesit në  
Planin Kombëtar  
të Përshtatjes të  
Shqipërisë**

Angazhimi i palëve të interesit do të jetë pikë qendrore në garantimin e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe të suksesit të Planit Kombëtar të Përshtatjes (PKP) të Shqipërisë. Duke përfshirë në mënyrë aktive institucionet qeveritare, komunitetet vendase, sektorin privat dhe shoqërinë civile, PKP-ja do të nxisë vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, do të krijojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe do të integrojë njohuritë vendore në strategjitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo qasje do të përmirësojë transparencën, llogaridhënien dhe bashkëpunimin, duke garantuar që masat e përshtatjes të jenë të barabarta, të përshtatshme dhe të qëndrueshme.

## 6.1 Strategjitë e hartëzimit dhe angazhimit

Hartëzimi i palëve të interesit do të identifikojë grupet e prekura nga ndërhyrjet klimatike dhe ndikimin e tyre në këtë proces. Instrumente të ndryshme, si diagramet e palëve të interesit, do t'i kategorizojnë pjesëmarrësit bazuar në kompetencat dhe interesin e tyre, duke mundësuar një angazhim të synuar. Për shembull, institucionet qeveritare me ndikim dhe interes të lartë do të përfshihen ngushtësisht në zhvillimin e politikave, ndërsa komunitetet vendase, pavarësisht ndikimit të ndryshueshëm, do të mbeten kritike për zgjidhjet praktike dhe të pranuar në nivel vendor. Do të përdoret gjithashtu hartëzimi sektorial, me fokus te sektorët e bujqësisë, energjisë, turizmit, transportit dhe zhvillimit urban, për të garantuar adresimin e nevojave sipas sektorit.

Strategjitë e angazhimit do të përshtaten për secilin grup interesi. Palët e interesit me ndikim të lartë, si p.sh. organet qeveritare dhe donatorët, do të angazhohen përmes konsultimeve dhe dialogëve strategjikë, duke garantuar harmonizimin me prioritetet kombëtare. Qasjet e bazuara në komunitet, si workshop-et dhe grupet e fokusit, do të fuqizojnë popullsitë lokale, veçanërisht gratë dhe grupet e marginalizuara për të krijuar bashkërisht zgjidhje. Këto metoda me pjesëmarrje jo vetëm që do të rrisin përfshirjen, por do të zbulojnë gjithashtu të dhëna vendore të cilat do të pasurojnë përpjekjet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

## 6.2 Qasjet përfshirëse

PKP-ja do t'i japë prioritet barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale në të gjitha aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit. Gratë, grupet e marginalizuara dhe popullsitë e cenueshme, të cilat ndikohen në mënyrë joproporcionale nga ndryshimet klimatike, do të ngrënë zërin e tyre përmes konsultimeve të synuara dhe komunikimit me ndjeshmëri gjinore. Instrumentet si mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë, do të gjurmojnë pjesëmarrjen dhe do të garantojnë parimin e barazisë në strategji. Masat praktike, si p.sh ofrimi i transportit dhe ambientet e aksesueshme, do të adresojnë pengesat sistematike, duke nxitur përfshirjen kuptimplotë.

Angazhimi sipas sektorit do të mbështesë më tej gjithëpërfshirjen. Për shembull, në bujqësi, konsultimet me fermerët e vegjël, shumë prej të cilëve janë gra, do të garantojnë adresimin e nevojave të tyre unike nga strategjitë e përshtatjes, si aksesimi në kulturat bujqësore rezistente ndaj ndryshimeve klimatike dhe praktikave për menaxhimin e burimeve ujore. Po ashtu, në turizëm, përfshirja e komuniteteve të marginalizuara në nismat e ekoturizmit do të mbrojë mjetet e jetesës duke nxitur njëkohësisht qëndrueshmërinë.

Transparenca do të jetë guri i themelit në të gjitha përpjekjet e angazhimit të palëve të interesit,

përmes komunikimit transparent të objektivave, veprimeve dhe rezultateve. Përditësimet periodike, raportimet e aksesueshme dhe monitorimi me pjesëmarrje do të krijojnë besim dhe besueshmëri, duke u mundësuar palëve të interesit që t'i vënë politikëbërësit para përgjegjësisë. Dialogu dhe bashkëpunimi i qëndrueshëm do të garantojë përshtatjen e vazhdueshme të PKP-së ndaj nevojave të ndryshueshme, duke përforcuar angazhimin e Shqipërisë në qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike përmes angazhimit strategjik dhe gjithëpërfshirës të palëve të interesit.

### 6.3 Veçoritë ndërvepruese për angazhimin e palëve të interesit

Për të përmirësuar efikasitetin e angazhimit të palëve të interesit, strategjia e komunikimit e PKP-së së Shqipërisë mund të integrojë mjete ndërvepruese që nxisin gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen aktive dhe dhënien e komenteve në kohë reale nga palët e interesit.

#### Workshop-e virtuale dhe webinar-e

- Mund të organizohen workshop-e virtuale sipas sektorit për të krijuar lidhje midis politikëbërësve, komuniteteve dhe ekspertëve teknikë.
- Platforma webinar-esh për të ofruar trajnime dhe konsultime të synuara, duke garantuar përfshirjen e palëve të interesit në zonat e largëta apo rurale.
- Përfshirja e seancave me pyetje-përgjigje dhe e anketave në kohë reale për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive dhe për të mbledhur komente nga palët e interesit.

Për shembull, një seri me workshop-e mbi “Zgjidhjet inteligjente ndaj klimës në bujqësi” mund të trajnojnë fermerët mbi praktikat më të mira, duke mbledhur njëkohësisht kontributin e tyre mbi sfidat vendore.

#### Platformat e narrativave ndërvepruese

- Faqja e PKP-së mund të përditësohet për të përfshirë narrativa ndërvepruese.
- Tregime vizuale, harta dhe përmbajtje multimedia për të treguar sfidat klimatike, zgjidhjet e përshtatjes sipas sektorit dhe historitë e suksesit në komunitet.
- Duhet të përfshihen instrumente navigimi për përdoruesit për t'u mundësuar palëve të interesit që të eksplorojnë raste studimore dhe të dhëna të lokalizuara të përshtatura sipas rajonit të tyre.

Për shembull, një hartë ndërvepruese që demonstroi rajonet e cenueshme dhe historitë e suksesit lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (si p.sh. projektet e rryllëzimit në Gjirokastrë ose nismat e energjisë diellore në zonat rurale të Shqipërisë).

#### Anketat online dhe mjetet për dhënien e komenteve

- Anketat digjitale janë të rëndësishme për të mbledhur komente nga palët e interesit në fazat e ndryshme të zbatimit të PKP-së.
- Kanale të qarta komunikimi për komunitetet, OJF-të dhe bizneset për të ndarë të dhëna, për të raportuar pengesa dhe për të propozuar zgjidhje.
- Të dhënat e anketave mund të përdoren për të mbështetur përditësimet dhe rishikimet e strategjive të komunikimit.

Për shembull, kryerja e një ankete digjitale pas uebinarit mund të ndihmojë në vlerësimin e njohurive të përfutuara, në marrjen e sugjerimeve dhe në identifikimin e hapave të ardhshëm për angazhim të mëtejshëm.

#### Fushatat ndërvepruese në rrjete sociale

- Platformat e rrjeteve sociale duhet të përdoren për të nisur fushata ndërvepruese që promovojnë objektivat e PKP-së.
- Për të angazhuar audiencat mbi temat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike mund të

krijohen instrumentet si sondazhet, kuizet dhe seancat e drejtpërdrejta me pyetje-përgjigje.

- Është shumë e rëndësishme që të ndahen historitë e suksesit dhe videot që përmbajnë projekte për përshtatjen të drejtuara nga komuniteti, për të frymëzuar pjesëmarrjen më të gjerë.

Për shembull, organizimi në Instagram i një serie kuizesh me temën “A e dini?” që thekson cenueshmëritë dhe zgjidhjet sipas sektorit në Shqipëri.

# 07

**Sistemet për  
Marrjen e  
Komenteve  
me Qëllim  
Përmirësimin e  
Vazhdueshëm**

**Për t'u siguruar që Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) i Shqipërisë të mbetet i përshtatshëm dhe efikas, është e rëndësishme të krijohen sisteme të qarta për marrjen e komenteve që demonstrojnë vlerën e kontributit të palëve të interesit dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në strategjinë e komunikimit. Mekanizmat për marrjen e komenteve duhet të mbledhin dhe analizojnë të dhënat e ndara gjatë takimeve, workshop-eve, anketave dhe platformave digjitale, si dhe të veprojnë bazuar në këto të dhëna, duke krijuar një proces komunikimi dinamik dhe të përshtatur.**

Takimet dhe workshop-et duhet të përfshijnë procese të strukturuar për marrjen e komenteve, si reflektimet pas eventit ose seancat ndërvepruese, ku pjesëmarrësit të mund të shprehin shqetësimet, sfidat, ose sugjerimet e tyre. Këto të dhëna duhet të analizohen me kujdes për të identifikuar mangësitë, për të adresuar keqkuptimet dhe për të përsosur strategjitë e komunikimit. Për shembull, nëse workshop-et theksojnë sfidat me të cilat përballen komunitetet rurale në aksesimin e praktikave bujqësore inteligjente ndaj klimës, strategjia e komunikimit duhet të përmbajë mesazhe dhe materiale të synuara e të zbatueshme, të përshtatura për të adresuar nevojat e tyre.

Po ashtu, rekomandohet që të përdoren platformat online dhe anketat digjitale si mjete për të mbledhur kontributet e palëve të interesit mbi efikasitetin e komunikimit dhe prioritetet për përshtatjen. Këto platforma ofrojnë një mënyrë dinamike për angazhimin e palëve të interesit, duke përfshirë të komunitetet në zonat e largëta, duke u lejuar atyre që të japin komente në fazat e ndryshme të zbatimit. Rezultatet e këtyre anketave jo vetëm që duhet të mbështesin rishikimet e strategjive të komunikimit, por gjithashtu duhet të ndihmojnë në matjen e efikasitetit të mesazheve dhe në përpjekjet e informimit me kalimin e kohës.

Transparenca është kritike për krijimin e besimit dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive. Ndaj, rekomandohet që të krijohen mekanizma të raportimit periodik për të demonstruar mënyrën se si komentet nga palët e interesit janë përfshirë në

proces. Në vijim të takimeve ose anketave, palët e interesit duhet të pajisen me raporte përmbledhëse që theksojnë të dhënat kyçe, masat e marra dhe rregullimet e bëra në strategjinë e komunikimit si rezultat i kontributit të tyre. Kjo vijimësi garanton që palët e interesit të shohin rezultatet konkrete nga pjesëmarrja e tyre, duke nxitur një ndjenjë të fortë përgjegjësie dhe llogaridhënieje.

Duhet të prezantohet gjithashtu një kuadër për përmirësimin e vazhdueshëm për të shqyrtuar dhe analizuar rregullisht komentet në nivel kombëtar dhe vendor. Duke monitoruar në mënyrë sistematike tendencat dhe duke identifikuar sfidat e përsëritura, strategjia e komunikimit mund të përshtatet për të pasqyruar prioritetet dhe nevojat në zhvillim. Ky proces ciklik mundëson që përpjekjet e Shqipërisë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike të mbeten të përshtatshme, duke garantuar që strategjia e komunikimit të angazhohet me efikasitet palët e interesit dhe të nxisë veprimet e përbashkëta.

Përfshirja e këtyre sistemeve për marrjen e komenteve do të forcojë aftësinë e PKP-së për të krijuar ndërlidhje me palët e interesit, duke demonstruar se zërat e tyre jo vetëm që kanë rëndësi, por edhe orientojnë aktivisht rrugëtimin e Shqipërisë në drejtim të qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo do të krijonte një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe të aftë për të adresuar sfidat reale në një mënyrë që frymëzon besim, përgjegjësi dhe bashkëpunim.

# 08

## **Plani i Zbatimit (2026–2028)**

**Plani i zbatimit, i cili paraqitet në mënyrë të detajuar më poshtë, përkthen pesë objektivat e komunikimit të PKAPI-së në veprimtari specifike, tregues, synime/objektiva, afate kohore, palët përgjegjëse dhe buxhetin indikativ që përfshihet në buxhetin e përgjithshëm të PKP-së. Secili prej objektivave shoqërohet nga një shpjegim i shkurtër i fokusit të tij, pasuar nga një ndarje e detajuar e veprimtarive.**

**Tabela 3. Plani i zbatimit i PKAPI-së (2026–2028).**

Veprimtaritë	Treguesit	Synimet	Periudha kohore	Palët përgjegjëse	Buxheti tregues (USD)	Potenciali i ndikimit në komunikim
<b>Objektivi 1: Rritja e ndërgjegjësimit për klimën</b>						
Të zhvillohen fushata multimediale specifike për sektorin (TV, radio dhe media sociale) duke u përqendruar në përshtatjen ndaj klimës në pesë fusha zhvillimi	Numri i fushatave  Numri i audiencave të arritura	6 fushata  (5 për secilin sektor dhe një e përgjithshme)  1.000.000 shikime/dëgjues	janar 2026-dhjetor 2028	Ekipi i PKP-së dhe ekspertët e komunikimit dhe shoqëritë mediatike	500.000	Ndërgjegjësim mbarëkombëtar, i përshtatur me sfidat dhe mundësit specifike të sektorit, duke nxitur angazhim në të gjithë Shqipërinë
Të krijohen mjete vizuale (p.sh., infografikë, postera, video) që tregojnë histori suksesi vendase për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në të pesë sektorët kryesorë, duke synuar audiencat më të reja.	Numri i materialeve të krijuara dhe të shpërndara për secilin sektor kyç	5.000 materiale të shpërndara	maj 2027	Të gjitha palët kyç të interesit	70.000	Të kuptuarit e zgjeruar të praktikave të suksesshme të përshtatjes, duke nxitur replikimin dhe mbështetjen
Të lehtësohen vizitat në terren me gazetarët në rajonet më të prekura nga ndryshimet klimatike, duke u mundësuar të dëshmojnë drejtpërdrejt ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe ta lidhin atë me politikat më të gjera të përshtatjes.	Numri i vizitave në terren  Numri i gazetarëve pjesëmarrës	3 vizita në terren  30 gazetarë të angazhuar	qershor 2026-dhjetor 2027	Gazetarët;  Shoqatat e mediave; ekspertët e klimës.	80.000	Raportim i përforcuar për klimën, me shtim të historive investigative mbi sfidat dhe përgjigjet e përshtatjes.
Të krijohen përmbajtje mediatike të bazuara në fakte që sfidojnë drejtpërdrejt keqinformimin me evidenca shkencore, duke përfshirë nismat e verifikimit të fakteve në fushatat mediatike.	Numri i artikujve që hedhin poshtë faktet dhe nismat për verifikimin e fakteve  Numri i mediave të angazhuara	10 artikuj të publikuar për verifikimin e hollësishëm të fakteve  5 media kryesore të përfshira	janar 2026-dhjetor 2028	Gazetarët investigativë; Ekipi i Komunikimit; Institucionet Shkencore.	90.000	Ulje e numrit të keqinformatave rreth klimës, rritja e besueshmërisë së lajmeve që lidhen me klimën.

Veprimtaritë	Treguesit	Synimet	Periudha kohore	Palët përgjegjëse	Buxheti tregues (USD)	Potenciali i ndikimit në komunikim
Të promovohet gazetaria investigative klimatike, ku gazetarët pyesin në mënyrë aktive politikëbërësit dhe kërkojnë llogaridhënie mbi angazhimet për përshtatje.	Numri i historive investigative të publikuara  Numri i seanceve të trajnimit për gazetarët	8 raporte investigative të publikuara  4 seanca trajnimi	qershor 2026- Dec 2028	Institucionet e Trajnimit të Gazetarëve.	150.000	Forcimi i pavarësisë së medias në raportimin për klimën, duke sjellë diskutim publik më të informuar.
<b>Objektivi 2: Forcimi i koordinimit institucional</b>						
Të zhvillohen workshop-e, trajnime dhe takime shumësektoriale me palët e interesit për bujqësinë, energjinë, transportin dhe turizmin për të përcaktuar rolet e tyre në strategjitë e përshtatjes.	Numri i workshop-eve, trajnimeve etj., sipas sektorit  Numri i pjesëmarrësve	25 workshop-e, takime trajnimi etj.  600 pjesëmarrës	qershor 2026-qershor 2028	Ministritë Sektoriale; Partnerët e Sektorit Privat	200.000	Të kuptuarit më të qartë të roleve, gjë që sjell strategji përshtatjeje më kohezive përfshirëse.
Të krijohet një grup i posaçëm ekspertësh për klimën, duke u siguruar që gazetarët dhe politikëbërësit të kenë qasje të drejtpërdrejtë në informacion të besueshëm për raportim dhe vendimarrje të bazuar në evidenca.	Numri i profileve të ekspertëve të disponueshëm  Numri i konsultimeve me ekspertë	1 grup ekspertësh i krijuar  50 50 konsultime të ofruara	janar 2026-dhjetor 2027	Institucione shkencore  UNDP  Gazetarë	75.000	Cilësi e përmirësuar e diskutimit për ndryshimet klimatike në media dhe politikëbërje.
Të sigurohet bashkëpunim më i gjerë midis gazetarëve dhe shkencëtarëve të klimës, për t'i bërë të dhënat e ndërlukuara më të arritshme për publikun.	Numri bashkëpunimeve  Numri i raporteve të thjeshtuara të publikuara për klimën	5 workshop-e me gazetarë ekspertë  10 raporte të publikuara për klimën	prill 2026-dhjetor 2028	Institucionet kërkimore për klimën  Gazetarë  UNDP	100.000	Rritje e saktësisë shkencore në lajmet për klimën dhe materialet për ndërgjegjësimin publik.
Të organizohen programe trajnimi për gazetarët me ekspertë të klimës për të ofruar njohuri të specializuara mbi strategjitë e përshtatjes, kuadrot e politikave dhe interpretimin e të dhënave.	Numri i programeve të trajnimit  Numri i gazetarëve të trajnuar	4 programe  80 gazetarë të trajnuar	janar 2026-dhjetor 2028	Gazetarë  UNDP  Institucione trajnimi; ekspertë të klimës.	180.000	Kapaciteti i forcuar për gazetari klimatike me cilësi të lartë.
Të publikohen instrumente mbi praktikatat inteligjente ndaj klimës për bujqësinë dhe turizmin, si dhe infrastrukturën e gjelbër për zhvillimin urban.	Numri i instrumenteve të shpërndara/shkarkuara	5000 kopje  3000 shkarkime	shkurt 2027	Ekspertë të sektorit; Ekipi i komunikimit	100.000	Udhëzime praktike për palët e interesit, duke nxitur miratimin e masave të përshtatjes.
<b>Objektivi 3: Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në narrativat e politikave</b>						
Të hartohen dokumente politikash që theksojnë përfitimet ekonomike nga energjia e rinovueshme, sistemet me aftësi ripërtëritëse dhe hapësirat e gjelbra urbane.	Numri i përmbljedhjeve të shpërndara të politikave  Vlerësimet e politikëbërësve	5 dokumente të shkurtra të ndara me 150 politikëbërës	shkurt 2027-dhjetor 2027	Ministria e Financave; Ministritë Sektoriale	150.000	Angazhim më i fortë politik për integrimin e përshtatjes në politikat kombëtare.

Veprimtaritë	Treguesit	Synimet	Periudha kohore	Palët përgjegjëse	Buxheti tregues (USD)	Potenciali i ndikimit në komunikim
Të organizohen dialogë mbi politikat e nivelit të lartë me palët kryesore të interesit në sektorët e bujqësisë, energjisë dhe transportit.	Numri i dialogëve të zhvilluar  Rezultatet e politikave	5 dialogë  Rekomandimet e politikave të zbatuara	shtator 2027	Ministritë e Sektorit; specialistët e advokimit	100.000	Harmonizim i përsheptuar i politikave me prioritetet e përshtatjes.
<b>Objektivi 4: Fuqizimi i zërave të cenueshëm</b>						
Të lehtësohen workshop-e, takime, trajnime etj., të synuara për gratë dhe të rinjtë mbi bujqësinë inteligjente ndaj klimës, eficiencën e energjisë dhe turizmin e qëndrueshëm.	Numri i workshop-eve  Numri i pjesëmarrësve	15 workshop-e, takime, aktivitete  300 pjesëmarrës	janar 2027-dhjetor 2027	Grupet e grave; udhëheqësit e komuniteteve	75.000	Pjesëmarrje e fuqizuar e grupeve të cenueshme në proceset e përshtatjes.
Të krijohen dhe të shpërndahen materiale edukative të përshtatura për komunitetet dhe shkollat në zonat rurale, duke u përqendruar në angazhimin e të rinjve në përshtatje.	Numri i materialeve të shpërndara  Shkalla e angazhimit të shkollës dhe komunitetit	10.000 kopje  200 shkolla	nëntor 2027	Ministria e Arsimit; OJQ-të	100.000	Angazhimi i nxitur nga të rinjtë siguron ndryshime afatgjata të sjelljes në aftësitë ripërtëritëse ndaj klimës.
Të forcohen programet e njohurive, veçanërisht në shkolla, për t'i ndihmuar brezat e rinj të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin mbi klimën.	Numri i shkollave të angazhuara  Numri i seancave të ndërgjegjësimit	100 shkolla  20 seanca ndërgjegjësimi	shtator 2026-dhjetor 2028	Ministria e Arsimit; OJQ-të	100.000	Përmirësim i qëndrueshmërisë së të rinjve ndaj keqinformimit mbi klimën.
<b>Objektivi 5: Vazhdimi i angazhimit dhe dialogut</b>						
Të theksohen arritjet e përshtatjes përmes blogjeve, videoeve dhe buletineve që shfaqin përpjekjet në të pestë sektorët.	Numri i historive të ndara të suksesit  Metrikat e angazhimit	15 histori suksesi  1.000.000 shikime	janar 2028-dhjetor 2028	Ekipi i komunikimit; udhëheqësit vendorë të projekteve	100.000	Ecuri e qëndrueshme dhe rritje e investimeve në praktikatat e suksesshme të përshtatjes.
Të vihet në funksion një platformë digjitale për të monitoruar ecurinë e përshtatjes dhe për të angazhuar palët e interesit me përditësime dhe mundësi për vlerësime.	Vënia në funksion e platformës  Përdoruesit aktivë  Dhënia e vlerësimeve	1 platformë  5000 përdorues aktivë	tetor 2027-mars 2028	Ekipi i TI-së; ekipi i komunikimit	60.000	Angazhimi i vazhdueshëm nxit transparencën dhe planifikimin bashkëpunues për përshtatje.

# 09

**Sfidat, Pengesat  
dhe Përshtatja  
Sipas Sfidave  
në të Ardhmen**

**Ndonëse Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) ofron një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për forcimin e qëndrueshmërisë së Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të adresohen disa sfida për të garantuar zbatimin e suksesshëm dhe përshtatjen e tij ndaj pasigurive të së ardhmes. Financimet e kufizuara publike dhe varësia e lartë në mbështetjen e jashtme financiare mund të ngadalësojnë zbatimin e nismave për përshtatjen, veçanërisht në nivel vendor, ku burimet financiare janë të pamjaftueshme. Ndryshimet në prioritetet politike, në alokimin e burimeve ose ndryshimet në leadership mund të ngadalësojnë më tej ritmin e masave të vazhdueshme dhe të planifikuara, duke vonuar ndërhyrjet kritike.**

Në nivel institucional, institucionet kombëtare dhe vendore kanë nevojë për mekanizma të fortë koordinimi, rritje të ekspertizës teknike, si dhe burime shtesë për të zbatuar me efikasitet strategjitë e PKP-së. Angazhimi i komunitetit, veçanërisht në zonat e largëta dhe rurale, mbetet i vështirë për shkak të ndërgjegjësimit, kapacitetit, ose besimit të kufizuar në proceset e përshtatjes, të cilat pengojnë pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse. Për më tepër, aksesit i kufizuar në të dhënat dhe projeksionet e sakta klimatike e ndërlikon vendimmarrjen e bazuar në prova, duke e bërë të vështirë prioritetimin e veprimeve dhe alokimin e burimeve në mënyrë efikase.

Për të adresuar pengesat dhe sfidat e ardhshme, strategjia e komunikimit e Shqipërisë duhet të mbetet dinamike dhe e përshtatshme. Mjetet e reja, si p.sh. platformat e narrativave ndërvepruese, mjetet e angazhimit virtual, si dhe instrumentet vizuale të udhëhequra nga të dhënat, duhet të shfrytëzohen për të thelluar informimin dhe komunikimin. Rishikimet periodike të cënueshmërive sipas sektorit, komentet e palëve të interesit dhe risqet klimatike në zhvillim, duhet të informojnë përditësimet strategjike, duke garantuar që mesazhet të mbeten të rëndësishme dhe të zbatueshme.

Duke i adresuar këto sfida në mënyrë proaktive dhe duke u fokusuar te përshtatja, Shqipëria mund të përmirësojë aftësinë e saj për t'iu përgjigjur rrethanave dinamike, ku përfshihen ndryshimet në prioritetet politike, risqet e reja klimatike, si dhe përparimet teknologjike. Kjo qasje garanton se PKP-ja do të vazhdojë të frymëzojë marrjen e veprimeve, rritjen e qëndrueshmërisë dhe sigurimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për Shqipërinë.

# 10

## **Konkluzione dhe Thirrje për Veprim**

Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP) i Shqipërisë përfaqëson një mundësi kritike për të mbrojtur zhvillimin socio-ekonomik dhe trashëgiminë natyrore të vendit nga ndikimet në rritje të ndryshimeve klimatike. PKP-ja garanton që të gjithë zërat të dëgjohen dhe të gjithë sektorët të mobilizohen drejt një të ardhmeje të qëndrueshme duke nxitur angazhimin gjithëpërfshirës, duke shfrytëzuar njohuritë vendase dhe duke promovuar strategjitë e barabarta të përshtatjes.

## Koha për të vepruar është tani.

Palët e interesit si qeveria, shoqëria civile, sektori privat dhe komunitetet lokale duhet të bashkohen për t'i vënë planet në zbatim. Shqipëria mund t'i transformojë sfidat klimatike në mundësi për rritje të qëndrueshme duke investuar në komunikim, zgjidhje novatore dhe në partneritete të forta bashkëpunimi.

**Së bashku, ne mund të ndërtojmë një Shqipëri të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike, duke garantuar një të ardhme më të sigurt e më të begatë për brezat e ardhshëm.**











GREEN  
CLIMATE  
FUND



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

